



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 shtator 2023
Nr. ref.:RK 2264/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI175/22

Parashtrues

Edison Muhaxheri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. 576/2021 të 12 shtatorit 2022,
të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Edison Muhaxheri (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 576/2021] të 12 shtatorit 2022, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme), përmes së cilit është ndryshuar Aktgjykimi [Ac. nr. 2610/17] i 26 qershorit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimit [C. nr. 2230/13] të 23 marsit 2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet] dhe 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.01/2023 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
5. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 2 dhjetor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 5 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [NR. Gjr. KI175/22] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
9. Më 30 gusht 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune që nga 15 qershori 2011 deri më 14 gusht 2013, me Pro Credit Bank Sh.a. (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi) në pozitën “Zyrtar i shërbimeve bankare”.
11. Më 14 gusht 2013, punëdhënësi përmes Njoftimit [nr. 13/969] e njoftoi parashtruesin e kërkesës se i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të riorganizimit të shërbimeve të punëdhënësit dhe pamundësisë së transferimit të tij në ndonjë vend tjetër të punës.
12. Më 20 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Komisionit të Ankesave të Departamentit të Burimeve Njerëzore të punëdhënësit kundër vendimit të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
13. Më 2 shtator 2013, Komisioni i Ankesave i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Punëdhënësit, përmes Vendimit [13/969] refuzoi ankesën e parashtruesit.
14. Më pas në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, kundër vendimit për largimin nga puna të punëdhënësit.
15. Më 13 nëntor 2013, Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës, përmes vendimit [nr. 567/2013] aprovoi kërkesën e parashtruesit dhe konstatoi se punëdhënësi me rastin e largimit nga puna të parashtruesit të kërkesës, ka shkelur dispozitat e Ligjit të punës dhe në këtë mënyrë vendimin me të cilin parashtruesi i kërkesës ishte larguar nga puna e konsideroi si të kundërligjshëm. Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës përmes vendimit të lartpërmendur dënoi punëdhënësin me gjobë në vlerë prej 6000 (gjashtë mijë euro) euro.
16. Më 5 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Vendimit [13/881] të 14 gushtit 2013 dhe Vendimit nr. 13/969 të 2 shtatorit 2013 të punëdhënësit, ku kërkoi anulimin e këtyre të fundit, kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave.
17. Më 23 mars 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C. nr. 2230/13] aprovoi në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi si në vijim: i) parashtruesin e kërkesës ta kthej në vendin e punës si “Zyrtar i shërbimeve bankare”; ii) të kompensoj parashtruesin e kërkesës në të ardhurat personale në vlerë prej 17,679.00 (shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntë) euro në emër të shpërblimit të dëmit në lartësinë e pagave për periudhën 29 shtator 2013 deri më 30 nëntor 2016; iii) kontributin pensional në vlerë prej 2,044.00 (dy mijë e dyzet e katër) euro; iv) tatimin që duhet t’i paguhet Administratës Tatimore në këto paga në vlerë prej 1,125.00 (një mijë e njëqind e njëzet e pesë) euro si dhe iv) shpenzimet e procedurës. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj theksoi se ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk ishte në pajtim me “kushtet e kontratës dhe dispozitat ligjore”, duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës dhe punëdhënësi kishin kontratë pune në kohë të pacaktuar dhe se vendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës ishte i paargumentuar.
18. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër vendimit të shkallës së parë, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 26 qershor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 2610/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e punëdhënësit, ndërsa vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata e Apelit në Aktgjykim shtoi se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, arsyetimi i aktgjykimit është i qartë dhe se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë në raport me gjendjen faktike të vërtetuar.
20. Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se më 21 shtator 2020, në funksion të zbatimit të aktgjykimeve [C. nr. 2230/13] të 23 marsit 2017 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimin [Ac. nr. 2610/2017] të 26 qershorit 2020 të Gjykatës së Apelit, punëdhënësi ftoi parashtruesin e kërkesës që të filloj punën tek punëdhënësi.
21. Më 25 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës dhe punëdhënësi kishin arritur "*Marrëveshjen për ndërprerjen e marrëdhënies së punës*", ku palët u dakorduan që me vullnetin e tyre të ndërpresin marrëdhënien e punës dhe që punëdhënësi të kompensoj parashtruesin e kërkesës në vlerë prej 7800 euro.
22. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi ushtroi revizion në Gjykatën Supreme, kundër dy vendimeve të instancave më të ulëta duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 12 shtator 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit ka pranuar si të bazuar revizionin dhe ndryshoi Aktgjykimin [C. nr. 2230/13] të 23 marsit 2017 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimin [Ac. nr. 2610/2017] e 26 qershorit 2020 të Gjykatës së Apelit, duke refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
24. Gjykata Supreme në arsyetim të aktgjykimit të saj shtoi se "*të dy gjykatat e lart përmendura gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se padia e paditësit është e bazuar*". Sipas Gjykatës Supreme, argumenti kryesor i saj është se sipas paragrafit 1, pika 1 dhe 3 të nenit 70 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, sepse bazuar në këto dispozita sipas Gjykatës Supreme, punëdhënësi ka qenë "*e detyruar të bëjë ndërprerjen e marrëdhënies së punës për paditësin, për faktin se ka bërë ristrukturim apo organizimin e ri të punës*", duke marrë parasysh se edhe selia në Pejë në të cilin kishte punuar parashtruesi i kërkesës ishte mbyllur.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.
26. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij fillimisht thekson se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, sepse atij në mënyrë të kundërligjshme i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës. Parashtruesi i kërkesës më tej në kërkesën e tij shton se vendimit të kontestuar i mungon "*baza juridike*".
27. Tutje, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson se "*Gjykata Supreme gjatë vendosjes lidhur me trajtimin e revizionit të palës së paditur ka shkelur në mënyrë flagrante të drejtat kushtetuese për një gjykim të drejtë nga fakti që pa asnjë bazë*

ligjore i ka refuzuar paditësit kërkesëpadinë, duke i pamundësuar që i njëjti të kompensohet për pagat të cilat është dashtë që t'i marr e që nuk i ka marrë si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme nga ana e punëdhënësit të paditurës, e duke i pasur parasysh faktet që e paditura nuk ka bërë asnjë përpjekje ta sistemoj në ndonjë pikë tjetër”.

28. Në mbështetje të pretendimeve të tij dhe në përforcim të pretendimit se është cenuar siguria juridike, parashtruesi i kërkesës thirret në rastin, *Ryabykh kundër Rusisë*, Aktgjykim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
29. Parashtruesi më tej ankohet edhe për procedurën e tejzgjatur gjyqësore, duke pretenduar se përkundër natyrës urgjente procedura ka zgjatur për më tepër se 10 vite.
30. Në fund, parashtruesi kërkon që Gjykata ta shpallë rastin e pranueshëm dhe të anulojë vendimin e kontestuar.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Neni 32 [E Drejta Për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet

ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 70

Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

1.2. i punësuari nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;

1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nën paragrafin 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër.

Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve

Neni 136
Bazat e përgjegjësisë

1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
33. Gjykata më tej i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. 576/2021] të 12 shtatorit 2022, të Gjykatës së Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.
35. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në

rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullit (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmachev kundër Francës, Kërkesa nr. 17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 4241/03](#), kategoria (iii)).
37. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
38. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me ndërprerjen e marrëdhënies së punës parashtruesit të kërkesës, nga ana e punëdhënësit me arsyetimin se punëdhënësi ka riorganizuar vendet e punës dhe për shkak se selia ku parashtruesi kishte qenë i punësuar mbyllet, i njëjti nuk mund të sistemohet në një vend tjetër të punës. Parashtruesi pasi ishte ankuar në instancën e dytë të punëdhënësit dhe në Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, kishte paraqitur padi në Gjykatë Themelore duke kërkuar kthim në vendin e punës dhe kompensim të pagave. Gjykata Themelore kishte aprovuar në tërësi padinë e parashtruesit dhe kishte vendosur që parashtruesi i kërkesës të kthehej në vendin e punës si dhe të kompensohej për pagat e papaguara. Më pas, pas ankesës së punëdhënësit në Gjykatën e Apelit kjo e fundit refuzoi ankesën duke miratuar plotësisht vendimin e shkallës së parë. Punëdhënësi në funksion të zbatimit të vendimit të shkallës së parë i miratuar edhe nga Gjykata e Apelit, kishte ftuar parashtruesin të kthehej në vendin e punës. Më pas rezultoi se parashtruesi i kërkesës dhe punëdhënësi kishin nënshkruar një “Marrëveshje për largim nga puna” për çka edhe punëdhënësi kishte kompensuar një shumë të caktuar parashtruesin. Punëdhënësi kishte parashtruar revizion në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të instancave më të ulëta dhe më 12 shtator 2022, Gjykata Supreme miratoi revizionin duke ndryshuar vendimet e instancave më të ulëta dhe refuzoi tërësisht padinë e parashtruesit.
39. Së pari, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në mënyrë shprehimore para Gjykatës kontestoi Aktgjykimin [Rev. 576/2021] të 12 shtatorit 2022, të Gjykatës Supreme, me të cilin ishte ndryshuar vendimet e instancave më të ulëta. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se bazuar në shkresat e lëndës të cilat gjykata i posedon “Marrëveshja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës” e lidhur më 25 shtator 2020,

në mes parashtruesit të kërkesës dhe punëdhënësit nuk është objekt shqyrtimi në Gjykatë dhe e njëjta nuk kishte qenë pjesë e ndonjë procedure gjyqësore.

40. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar shkel të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
41. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me shkeljen e nenit 31 në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe që ka të bëjë me (i) me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material, nga ana e Gjykatës Supreme; si dhe (ii) tejzgjatjen e procedurave gjyqësore.
42. Gjykata në vijim këto dy pretendime do t'i trajtojë ndaras, duke filluar me pretendimin për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material nga ana e Gjykatës Supreme për të vazhduar me pretendimin për tejzgjatje të procedurës.

Përkitazi me pretendimet nën pikën (i) – mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material

43. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kontekst të pretendimit të tij për interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit thekson se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar, kur ka pranuar revizionin e punëdhënësit dhe ka refuzuar tërësisht padinë e parashtruesit të kërkesës “*ka shkelur në mënyrë flagrante të drejtat kushtetuese për një gjykim të drejtë*”, nga fakti që pa asnjë bazë ligjore i ka refuzuar parashtruesit të kërkesës kërkesëpadinë duke i pamundësuar që i njëjti të kompensohet për pagat të cilat është dashtë që t'i marr e që nuk i ka marrë si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme nga ana e punëdhënësit.
44. Nga pretendimet e paraqitura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës Supreme.
45. Prandaj, bazuar në shtjellimet e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit hyjnë në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.
46. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. KI87/20, parashtrues *Suva Rechtsabteilung*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 57; KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtrues *X*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55 dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).
47. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, gjë që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të

vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin *Ballıktaş Bingöllü kundër Turqisë*, GJEDNJ, nr. 76730/12 i 22 qershorit 2021, paragrafi 75; *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; si dhe rastet e cekura më lart KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).

48. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih, rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Ruisë*, kërkesa nr. 65167/01, Vendimi për pranueshmëri, i 30 qershorit 2005; dhe rastet e Gjykatës të cituara më lart KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 38; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
49. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Ruisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
50. Në rastin konkret, Gjykata ka parasysh se Gjykata Supreme kishte aprovuar tërësisht revizionin e paraqitur nga punëdhënësi dhe kishte ndryshuar vendimet e instancave më të ulëta, duke refuzuar padinë e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata rikujton se në revizionin e paraqitur në Gjykatën Supreme nga punëdhënësi, ky i fundit kontestoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
51. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 576/2021], të 12 shtatorit 2022, bazuar në dispozitat e nenit 211, 212 dhe 215 të të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kishte vlerësuar se revizioni i punëdhënësit në rastin konkret është i bazuar. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme theksohet se gjykatat e instancave më të ulëta gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë.
52. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 576/2021], të 12 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme, e cila kishte theksuar se gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë zbatuar drejt të drejtën materiale, ndër të tjera, duke theksuar:

"Këtë pikëpamje juridike gjykata e revizionit e mori për faktin se është e qartë se në bazë të nenit 70 paragrafi 1, pika 1 dhe 3 të Ligjit m. 03/1-212 të punës, parashihet se: "Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit

me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur: 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative dhe 1.3, punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë pune tjetër", ndërsa këto dispozita ligjore gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë i kanë zbatuar në mënyrë të gabuar. Nga gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, shihet çartë se e paditura ka qenë e detyruar të bëjë ndërprerjen e marrëdhënies së punës për paditësin, për faktin se ka bërë ristrukturimin apo organizimin e ri të punës, për shkak të mbylljes së zyrës së bankës në Pejë SP II-rr. "Mehmet Shoshi", m.2, zyrë ku ka punuar paditësi. Gjukata duke pas parasysh se e paditura ka shqyrtuar mundësinë e transferimit apo sistemimin e paditësit në një vend tjetër të punës, por për shkak të pamundësisë, së transferimit, për shkak të numrit të madh të punëtorëve, dhe faktit se në të gjitha njësitë ka pasur zvogëlim të numrit të punëtorëve, ka qenë e detyruar në ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit. E paditura në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të paditësit i ka respektuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore, të lartcekura, pasi që më datë 30.11.2016, e njëjta e ka ftuar paditësin paraprakisht për ta njoftuar për riorganizimin dhe ristrukturimin e sistemit të punës, dhe konkretisht mbylljen e njësisë në të cilën ka punuar paditësi dhe njoftimin e pamundësisë së transferimit të ri në një njësi tjetër, për shkak të numrit të madh të punëtorëve edhe në njësitë e tjera. Ndërprerja e marrëdhënies së punës për paditësin është në përputhje me dispozitat e lartcekura për faktin se ndërprerja është bërë për arsye të mbylljes së njësisë në të cilën ka qenë duke punuar paditësi dhe kjo vërtetohet me vendimin e Bordit Menaxhues të datës 22.04.2013, dhe mbyllja është bërë për arsye ekonomike teknike dhe organizative, të cilën mbyllje e ka aprovuar edhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, si autoritet mbikëqyrës, që nënkupton se me rastin e ndryshimeve strukturore janë përfillur procedurat e parapara, dhe me njoftimin paraprak nga ana e të paditurës, prandaj një vendim i tillë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për Gjukatën Supreme është i drejt dhe i ligjshëm, dhe nuk përbën shkelje të drejtave nga marrëdhënia e punës".

53. Nga si më sipër Gjukata rikujton se përmbajtjen e nenit 70 (Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit) të Ligjit të Punës, i cili parasheh si në vijim:

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:
 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
 1.2. i punësuarin nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;
 1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër

54. Gjukata ripërsërit se Gjukata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjukatës të cituar më lart, KI75/17, parashtrues X, paragrafi 59).

55. Megjithatë, bazuar në shtjellimet e mësipërme, si dhe interpretimin dhe arsyetimin e dhënë, në rastin konkret, nuk është dëshmuar që ka arbitraritet në interpretimin e

dhënë nga Gjykata Supreme me rastin e refuzimit të padisë së parashtruesit dhe pranimin e revizionit të parashtruar nga punëdhënësi.

56. Prandaj, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i aplikimit në mënyrë diskriminuese të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i “*ligjshmërisë*” nga Gjykata Supreme, mund të ketë qenë jo i drejtë.
57. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka arritur të dëshmojë dhe të mbështesë pretendimin e tij se si Gjykata Supreme gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për tejzgjatje të procedurave gjyqësore

58. Në trajtim të këtij pretendimi, Gjykata fillimisht rikujton edhe një herë këtë pretendim të parashtruesit, i cili ndër të tjera thekson se përkundër natyrës urgjente të rastit si kontest pune, rasti në gjykata të rregullta ka zgjatur për më shumë se 10 vite.
59. Përkitazi me pretendimin për tejzgjatje të procedurës, Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se neni 6 (1) i KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në çështjen *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91).
60. Sa i përket shtrirjes në kohë të procedurave, Gjykata merr parasysh kriteret e GJEDNJ-së të përcaktuara në Aktgjykimin e rastit *Tomazič kundër Sllovenisë*, (Aktgjykimi i 2 qershorit 2008, paragrafi 54), ku përcaktohet si në vijim: “*Sa i përket arsyeshmërisë së zgjatjes së procedurave, [GJEDNJ] thekson se kjo duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke pasur parasysh kriteret në vijim: ndërlikueshmëria e rastit, veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe autoriteteve relevante, si dhe çfarë ishte në pyetje për parashtruesin në këtë mosmarrëveshje*”.
61. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës së saj, ka vlerësuar se përlllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, të 23 prillit 1987, paragrafi 64, shih gjithashtu rastin *Poiss kundër Austrisë*, GJEDNJ, të 23 prillit 1987, paragrafi 50, dhe rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI127/15, me parashtrues *Mile Vasovič*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 qershorit 2015, paragrafi 43, KI81/16, me parashtrues *Valdet Nikqi*, Aktgjykim i 31 majit 2017, KI19/17, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 shkurtit 2018, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74).
62. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kemi të bëjmë me kontest pune i cili fillimisht me padi është iniciuar nga parashtruesi i kërkesës më 5 shtator 2013, dhe shkalla e parë,

përkatësisht Gjykata Themelore ka aprovuar kërkesëpadinë në vitin 2017, më pas pas ankesës së punëdhënësit në Gjykatën e Apelit kjo e fundit kishte vendosur në vitin 2020 dhe procedura ka përfunduar me vendimin e kontestuar, më 13 shtator 2022.

63. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së rastit, Gjykata thekson se gjatë vlerësimit të pretendimit të palëve lidhur me tejkzgjatjen e procedurave, ndërlikueshmëria e një procedure duhet të shqyrtohet në kuadër të aspektit faktik dhe juridik të kontestit në fjalë (shih rastin e Gjykatës, KI19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 shkurtit 2018, paragrafi 56).
64. Gjykata thekson se në bazë të fakteve të elaboruara më lart, rasti i parashtruesit të kërkesës mund të konsiderohet si i ndërlikuar, në vështrim të gjendjes faktike dhe juridike, për shkak të vendimeve të kundërta gjyqësore në shkallë ndryshme si dhe interpretimeve të ndryshme të legjisllacionit në fuqi.
65. Përkitazi me veprimet e palëve në procedurë, Gjykata thekson se, në dritën e praktikës gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ-së, tejkzgjatja e procedurës vlerësohet edhe nga veprimet e palëve të cilat marrin pjesë në procedurë (shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 15 korrikut 1982, paragrafi 82; shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 shkurtit 2018, paragrafi 62).
66. Lidhur me veprimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka qenë aktiv duke ndërmarrë shumë veprime procedurale, gjegjësisht duke ndjekur hapat procedural të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë, Gjykata vëren se pas Aktgjykimit [Ac. nr. 2610/2017] të 26 qershorit 2020, parashtruesi i kërkesës dhe punëdhënësi kishin arritur marrëveshjen për ndërprerjen e punës.
67. Më pas, pas parshtrimit të revizionit nga ana e punëdhënësit në Gjykatën Supreme, nga shkresat e lëndës nuk rezulton që parashtruesi i kërkesës të ketë parashtruar ndonjë urgjencë për përsheptim të rastit.
68. Lidhur me veprimet e organeve kompetente në procedurën e lartpërmendur, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies së tyre në lëvizje ishin aktive në gjykimin e çështjes, ku gjatë gjithë procedurës janë nxjerrë gjithsej tre vendime gjyqësore. Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se rasti në shkallë të parë ka zgjatur gjithsej 3 vite e gjashtë muaj, më pas në Gjykatën e Apelit rasti ka zgjatur 2 vite e 8 muaj dhe pas parashtrimit të revizionit rasti në Gjykatën Supreme ka zgjatur 2 vite e 10 muaj. Nga kjo rezulton se e gjithë procedura nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në vendimin e kontestuar janë gjithsej 8 vite e 10 muaj.
69. Gjykata, në dritën e rrethanave të këtij rasti, duke marrë parasysh bazën ligjore, veprimet e shumta e palëve procedurale, interesat legjitime të tyre dhe mjetet ligjore të përdorura nga palët, si dhe faktin se gjykatat kanë nxjerrë gjithsej tri vendime gjyqësore në këtë rast, arrin në përfundimin se gjykatat e rregullta, që nga momenti i vënies në lëvizje në këtë rast, nuk ishin pasive. Pra, bazuar në shkresat e lëndës dhe në dritën e rrethanave të rastit, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies në lëvizje ishin aktive në gjykimin e çështjes dhe, rrjedhimisht, nuk kanë shkaktuar tejkzgjatje të paarsyeshme të procedurës.
70. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se lidhur me pretendimin e parashtruesit për tejkzgjatje të procedurës, parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati kohor të

arsyeshëm, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk dëshmojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij këtë të drejtë kushtetuese.

71. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se parashtruesi në këtë drejtim nuk ka ofruar asnjë arsyetim dhe duke mos mbështetur pretendimet e tij rreth mënyrës se si Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkelë nenet e lartcekura.
72. Gjykata, gjithashtu, rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KI02/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafi 36; dhe KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).
73. Prandaj, pretendimet e lartpërmendura të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë janë pretendime “*të shkallës së katërt*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 34 (2), si dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 30 gusht 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. TË KONSTATOJË që ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Grësa Caka-Nimani